



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE  
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 4480 Prot

Tiranë, më 5. 9. 2014

**URDHËR**

Nr. 1406, datë 5. 9. 2014

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË ILDKPKI**

Në zbatim të Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (i ndryshuar), të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar), dhe të Rregullores së Brendshme të institucionit,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Zbatimin e menjëhershëm të dispozitave të kësaj Rregulloreje nga të gjithë punonjësit e institucionit.
3. Moszbatimin e kësaj Rregulloreje passjell përgjegjësi disiplinore dhe administrative.
4. Shfuqizimin e Rregullores së miratuar me Urdhërin Nr.55, datë 20.03.2009.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Shkëlqim GANAJ**

